

## **I. PËR NOCIONET THEMELORE JURIDIKE**

### **NOCIONET KRYESORE:**

**normë juridike; rregullim juridik; sistem juridik; institut juridik(ent, institut); degë juridike; sferë juridike; e drejta e mbrendëshme; e drejta ndërkombëtare; e drejta materiale; e drejta formale (procesore); kushtetuta në kuptim material; kushtetuta në kuptim formal; vlerat themelore; sundimi i së drejtës; pluralizmi politik.**

### **PYETJE:**

- 1. Çka është norma juridike ?**
- 2. Çka është rregullimi juridik ?**
- 3. Çka është sistemi juridik ?**
- 4. Çka është instituti juridik ?**
- 5. Çka është dega juridike?**
- 6. Çka është sfera juridike ?**
- 7. Numëroni disa dega juridike ?**
- 8. Paraqitni disa shembuj nga sferat juridike ?**
- 9. Çka nënkuptojmë me fjalën kushtetutë ?**
- 10. Sqaroni natyrën politike të kushtetutës?**
- 11. Pse Kushtetuta është akt më i lartë juridik?**
- 12. Cfarë lloje të kushtetutave ekzistojnë?**
- 13. Në sa faza mund të ndahet zhvillimi kushtetues në Republikën e Maqedonisë ?**
- 14. Sqaroni parimin e qeverisjes të së drejtës si vlerë themelore e rregullimit kushtetues në RM!**
- 15. Ç'është thelbi i pluralizmit politik si vlerë themelore e rregullimit kushtetues?**
- 16. Çka është sundimi i së drejtës?**
- 17. Prej çka përbëhet struktura e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë?**
- 18. Numëroni disa ndarje nga teksti normativ i Kushtetutës së RM!**

## 1. Për nocionet themelore juridike

Sjellja e njerëzve rregullohet me lloje të ndryshme normash : morale, religjioze, juridike... Bashkësia shoqërore është e pa mundur të ekzistojë pa ekzistimin e rregullave të cilat e rregullojnë jetën në të. Nga të gjitha rregullat që rregullojnë sjelljen e njeriut, normat juridike janë më të rëndësishmet.

*Norma juridike* është rregull shoqërore e detyrueshme për sjelljen e njerëzve e sjellë (ose) e sanksionuar nga shteti, gjegjësisht e mbrojtur nga aparati shtetëror për dhunë. Ajo do të thotë se rregulli shoqëror për sjelljen e njerëzve mund të krijohet edhe nga ana e shtetit, kur ajo është e sjellë nga ana e organit kompetent shtetëror, ose shteti të sanksionojë normë të caktuar shoqërore ( morale, zakonore) që më ekziston. Fuqia dhe rëndësia e normës juridike rrjedh nga fakti se ajo është e mbrojtur nga aparati shtetëror për dhunë. Ai fakt edhe e dallon nga normat e tjera shoqërore, respektivisht zbatimi i tyre nuk sigurohen nga ana e shtetit.

Normat juridike janë të lidhura në rregullimin dhe në sistemin juridik.

*Rregullimi juridik* është rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore të rregulluara me norma juridike. Ai paraqet bashkimin e normave juridike dhe marrëdhëniet e njerëzve ndaj të cilëve zbatohen normat (elementi faktik dhe normativ i rregullimit juridik).

*Sistemi juridik* është përmbledhje e normave të përgjithëshme juridike, të sistematizuara sipas rregullave të caktuara në grupe adekuate të mëdha dhe të vogla, ashtu që bashkërisht formojnë tërësi të veçantë dhe jokundërthënëse. Grupimi i normave juridike në tërësi të caktuara bëhet në bazë të ngjashmërisë së tyre. Kriteri që përdoret më shpesh për sistematizimin e normave juridike është përmbajtja e tyre, gjegjësisht, përmbajtja e marrëdhënieve shoqërore të cilat ato i rregullojnë. Sipas këtij kriteri, ekzistojnë : enti juridik, dega juridike dhe sfera juridike .

*Enti juridik (institucioni)* i përfshin normat juridike të cilat rregullojnë marrëdhëniet e njëjta shoqërore, gjegjësisht rregullojnë sjelljen e njëjtë të njerëzve (p.sh. martesë, adoptimi, shitblerja, pronësia etj)

*Dega juridike* është përmbledhje e më shumë enteve juridike të cilët rregullojnë lloje të njëjta të marrëdhënieve shoqërore. së pari janë formuar e drejta penale dhe e drejta qytetare, ndërsa pastaj janë paraqitur edhe degët e tjera juridike (e drejta kushtetuese, e drejta administrative, e drejta e punës, e drejta tregtare, e drejta financiare etj). Numri i degëve juridike është i ndryshueshëm. Në vende të ndryshme , ekzistojnë degë të ndryshme juridike. Edhe në sistemin juridik të një vendi, gjatë zhvillimit historik, numri dhe llojet e degëve juridike ndryshon.

*Sfera juridike* është pjesë e sistemit juridik e përbërë nga më shumë degë juridike. Degët juridike grupohen në sfera juridike në bazë të kriterëve të ndryshme. Ashtu që mund të flitet për të drejtën e mbrendëshme (e cila i përfshin degët juridike që rregullojnë marrëdhëniet e brendshme juridike, d.m.th. marrëdhëniet juridike në suazat e një shteti) dhe për të drejtën ndërkombëtare (e drejta ndërkombëtare publike, e drejta ndërkombëtare private) ose për të drejtën materiale

e cila rregullon sjelljet e subjekteve juridike -të drejtat dhe detyrimet e tyre)dhe për të drejtën (procesore) formale( e cila i përfshin normat juridike të cilat shërbejnë për realizimin e normave materiale - juridike) etj. Normat juridike të cilat e përbëjnë drejtësinë në një shtet duhet të jenë në pajtueshmëri midis tyre. Ajo arrihet me vënien e relacionit të klerarkisë midis tyre. Në kulmin e shkallës së klerarkisë gjenden normat kushtetuse. Kushtetuta është akt më i lartë juridik në secilin shtet. Ajo i rregullon marrëdhëniet më të rëndësishme në shtet dhe i vendos principet themelore në bazë të të cilëve ndërtohet sistemi i tërësishëm juridik. Të gjitha normat juridike të përmbajtura në aktete tjera juridike duhet të jenë në pajtueshmëri me kushtetutën e vendit.

Menjëherë pas kushtetutës, sipas fuqisë së tyre juridike, gjenden ligjet të cilat i sjell parlamenti dhe të cilët duhet të jenë në pajtueshmëri me kushtetutën. Më tytje shkalla klerarkike vazhdon me aktet nënligjore (dekrete, urdhëra, vendime dhe ngjashëm) të cilët i sjellin organet e pushtet (qeveria, ministritë, kryetari i shtetit), aktet e njëjive të vetëqeverisjeve lokale (statuti, vendimi dhe ngjashëm),kontratrat kolektive të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri edhe me kushtetutën edhe me ligjet e vendit.

Më detajisht do të përqëndrohemi te kushtetuta, si akt më i rëndësishëm juridik e cila i normon marrëdhëniet më kryesore të një vendi.

## 2. Kushtetuta

Kushtetuta është dokument (akt) politiko- juridik me të cilën garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të qytetarit dhe rregullohen bazat e sistemit politik, juridik dhe shoqëror në tërësi.

*Natyra politike* e këtij akti rrjedh nga fakti që atë e sjellin fuqitë politike qeveritare(subjektet) të cilat vendosin për formën, përmbajtjen dhe thelbin e saj,, nga njëra anë, si edhe nga shkaku i karakterit politik i marrëdhënieve dhe institucioneve të shumta të cilat rregullohen dhe vendosen me kushtetutë.

*Natyra juridike* e këtij akti është se dispozitat e këtij akti vlejné për të gjithë (erga omnes) dhe i obligojné të gjitha subjektet.

Kushtetuta është akt më i lartë juridik, ligj më i lartë (lex superior), ligj mbi ligjet. Me atë duhet të jenë në pajtueshmëri të gjitha aktet juridike.

Ajo është edhe akt më i përgjithshëm juridik.

Kushtetutat dallohen nga përmbajtja, struktura dhe sistemimi. Në historinë dhe teorinë kushtetuse të njohura janë më shumë klasifikime të kushtetutës, varësishtë prej kriterit që merret për analizë.

Dallojmë kushtetutë me kuptim material (nacioni material) dhe kushtetutë me kuptim formal (nacioni formal).

Me fjalën *kushtetutë në kuptimin material* nënkuptojmë sistem (tërësi) të parimeve dhe normave themelore (të shkruara ose të pashkruara) në të cilat rregullohen marrëdhëniet themelore të shtetit dhe shoqërisë.<sup>1</sup>

*Kushtetutë në kuptim formal* (nacion formal) është dokument i shkruar me fuqi më të lartë juridike e sjellë nga organi përfaqësues i cili është bartës i pushtetit ligjdhënës ose nga organ special kushtetues, me procedurë të veçantë (më të ndërlikuar) nga ajo sipas të cilës sillen ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera.

Kushtetutat në kuptimin material dhe formal shpesh herë nuk përputhet me realitetin.

Ndarja e kushtetutave në të shkruara dhe të pashkruara bazohet në kriterin formalo- juridik. Të shkruara janë ato kushtetuta të cilat materien kushtetuto-juridike e shprehin në formë të shkruar, ndërsa kushtetuta të pashkruara janë të ashtuquajturat kushtetutat zakonore, të përbëra nga rregulla në forma të pashkruara.(zakone). Të parat (të shkruarat) quhen edhe kushtetuta në kuptim formal, ndërsa të dytat si kushtetuta në kuptim material ose si kushtetuta historike, gjithashtu. Kushtetutat e pashkruara u kanë paraprirë atyre të shkruarave, ndërsa sot mbizotrojnë të dytat. Shembull i kushtetutës zakonore është kushtetuta angleze, por ajo, përveç zakoneve përmban edhe një numër të madh të dokumenteve të shkruara.<sup>2</sup>

Ndarja e kushtetutave në të forta dhe të buta rrjedh nga regjimi (procedura) juridik për ndryshimin e kushtetutës. Të forta janë ato kushtetuta që për ndryshimin e tyre është e nevojshme procedurë e veçantë më e ndërlikuar se ajo ligjdhënëse, ndërsa kushtetuta të buta janë ato të cilat ndërrohen nga organet e njëjta (të cilat i sjellin ligjet) dhe në mënyrë të njëjtë (procedurë) siç sillen dhe ndryshohen ligjet.

Në teorinë kushtetuese - juridike flitet edhe për kushtetuta të ashtuquajtura gjysmë të forta dhe gjysmë të buta, varësisht nga shkalla e ndërlikueshmërisë së procedurës për ndryshim, si edhe për kushtetuta hibride, që disa pjesë të saja kanë karakter të kushtetutave të forta, ndërsa pjesët të tjera kanë karakter të kushtetutave të buta.

Në klasifikimin klasik të kushtetutës haset edhe ndarja e kushtetutave të kodifikuara dhe të jokodifikuara. Të parat janë të paraqitura në një akt, ndërsa të dytat janë të përmbajtura në më shumë akte.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Kuptohet, kushtetuta në kuptim material trajtohet ndryshe nga mendimtarë të ndryshëm. Disa prej tyre, nocionin material të saj e lidhin me shtetin (Jelinek, Bartelemi, Ruffija), të tjerë me pushtetin politik (Diverzhe), të tretë me të drejtën (Kelzen), ndërsa të katërt me marrëdhëniet faktike të forcave në shoqëritë konkrete. (Lasel).

<sup>2</sup> Anglia, kuptohet, nuk ka kushtetutë në kuptim formalo - juridik, d.m.th. si ligj themelor i sistematizuar i vendit, por ka kushtetuta me kuptim materialo - juridik.

<sup>3</sup> Shembull historik për kushtetutë të pakodifikuara është Kushtetuta e Republikës së tretë franceze të vitit 1958, e përbër nga tri ligje kushtetuese: Ligji për organizimin e pushtetit publik, Ligji për organizimin e Senatit dhe Ligji kushtetues për marrëdhëniet mesveti të pushtetit publik. Shembull bashkëkohor të kushtetutës heterogjene është kushtetuta e Izraelit, me të cilën karakter kushtetueso-juridik kanë: Ligji për themelimin e Izraelit i vitit 1948, Ligji kalimtar i vitit 1949, Ligji themelor për Knesetin i vitit 1958, Ligji për kryetarin e shtetit i vitit 1958 dhe të tjerë.

Sipas vëllimit, kushtetutat ndahen në të plota (tërsishme), të stërgjera dhe jo të plota. Kushtetutë e tërsishme është ajo e cila i mbulon të gjitha elementet e rëndësishme (marrëdhëniet shoqërore) të karakterit kushtetueso - juridik. Kushtetutë e stërgjerë është kushtetuta më e detajuar d.m.th. kushtetuta që përmbanë elemente të karakterit ligjor. Kushtetutë jo e tërsishme është ajo e cila materien kushtetueso - juridike e përfëshin pjesërisht.

Nga aspekti i përmbajtjes, kushtetutat kalsifikohen si : deklarative , konstitutive dhe programore. Kushtetuta deklarative është ajo e cila paraqet deskripcionin (përshkrimin) e gjendjes së vazhdueshme në shoqëri. Kushtetuta konstitutive është kushtetuta ku me dispozitat e saja inicon formimin e gjendjeve të reja, ku janë të përcaktuara përmbajtja dhe koha. Kushtetuta programore skicon korniza dhe drejtime për zhvillimin e saj të mëtutjeshëm dhe realizimi i saj nuk është i afatizuar, por varet nga plotësimi i kushteve të caktuara paraprake.

Nga aspekti i kohëzgjatjes, kushtetutat mund të jenë stabile dhe afatshkurte. Stabile është ajo kushtetutë që relativisht vlen një periudhë të gjatë, ndërsa afatshkurte është ajo me afat më të shkurtër.

Sipas shkallës së përputhshmërisë të normave kushtetuese me gjendjen reale dallojmë: kushtetuta reale, joreale, (nominale) dhe fiktive(mistifikatore). Reale janë ato kushtetuta të cilat nisen nga gjendja faktike, për atë edhe janë të realizueshme. Kushtetuta joreale (nominale) janë kryesisht deklarative dhe më shumë shprehin qëllim se sa mundësi. Kushtetuta fiktive është akt ekstrem joreal, fikSION larg nga realiteti. Nga teoria kushtetuese, hasen edhe nocione të tjera për kushtetutën: nocioni filozofik, (Aristoteli, Hegeli), politik (Levenshtajn, Shmit) dhe klasifikime të tjera.

Te secili kalsifikim nuk ekziston tip, gjegjësisht model i pastërt.

### 3. Zhvillimi kushtetues i Republikës së Maqedonisë (1946-1991)

Zhvillimi kushtetues i shtetit maqedon prej vitit 1946 deri në vitin 1991 mund të ndahet në tri periudha.

Periudha e parë fillon nga viti 1946 dhe zgjat deri në sjelljen e kushtetutës së vitit 1963. Kjo periudhë shpaloset në dy faza :deri në sjelljen Ligjit kushtetues për rregullimin shoqëror dhe politik dhe për organet e pushtetit prej vitit 1953 dhe më pas. Në shkencën politike dhe juridike faza prej vitit 1946 - 1953 përcaktohet si socializëm shtetëror ,demokraci popullore, etatim revolucionar, shtet i avangardës, për shkak të ndikimit famoz të Partisë Komuniste dhe udhëheqësve të saj.

Periudha e dytë kushtetuse fillon me sjelljen e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë nga viti 1963 dhe zgjat deri në vitin 1974. Në këtë periudhë u ekzekutuan disa ndryshime kushtetuese. Shenjë kryesore e kësaj kohe është ndeshja në mes etatizmit dhe vetëqeverisjes.

Periudha e tretë kushtetuse fillon me sjelljen e Kushtetutës së vitit 1974 dhe zgjat deri në sjelljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë në 17.11.1991. Në këtë periudhë janë ekzekutuar më shumë ndryshime të amandamenteve ( viti 1981,1989) me të cilat u krijuan pargjykime kushtetuese për demokracin shumëpartiake parlamentare.

Monizmi partiak, mungesa e mekanizmave demokratiko - politike dhe juridike dhe garat në tregti, pronësia shoqërore, fryma kolektive dhe kultura politike autoritative sollën erozionin dhe shkatërrimin e sistemit.

Kthimi nga traditat dhe standartet liberale evropiane u bë nevojë kushtetuse.

#### 4. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991

Kushtetutës së vitit 1991 i paraprinte Deklarata për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë dhe Referendumi për sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë. Deklarata u soll më 25.01.1991, njëzëshëm nga të gjithë deputetët e Kuvendit të R. Maqedonisë, në bazë të nenit 318 nga Kushtetuta e RSM nga viti 1974 dhe Paktit ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike të OKB-së nga viti 1996, në të cilën garantohen të drejtat e çdo populli që lirisht ta përcaktojë statusin politik dhe shoqëror, zhvillimin kulturor dhe ekonomik.

Referendumi u realizua më 08.09.1991, në bazë të Vendimit për shpalljen e referendumit, e sjellë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.<sup>4</sup> Në Referendum dolëm 75.74 % nga zgjedhësit, ndërsa votuan "PËR" 95.26% nga zgjedhësit. Rezultati flet për vullnetin e shprehur plebishitar për pavarësi dhe sovranitet të Republikës së Maqedonisë.

Pas debatit publik për Projekt Kushtetutën e vitit 1991, me 92 vota "PËR" nga gjithsej 120 deputetë, më 17.11.1991, Kuvendi e solli Kushtetutën e parë të pavarur dhe sovranë të Republikës së Maqedonisë.<sup>5</sup>

Kushtetuta e vitit 1991 nga karakteri i saj është liberalo-demokratike. Në frymën e liberalizmit klasik nga shekulli XIX vend qëndror në të kanë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarit. Ajo garanton barazi të qytetarëve , pavarësisht nga gjinia, rasa, ngjura e lëkurës, nacionaliteti dhe origjina sociale, besimi fetar dhe politik, pozita pronësore dhe shoqërore.

Në nenin 8 alineja 1 të Kushtetutës janë përcaktuar vlerat themelore të rregullimit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, siç janë:

- të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të qytetarëve , të miratuara nga e drejta ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- shprehja e lirë e përkatësisë nacionale;
- qeverisja e së drejtës;
- ndarja e pushtetit në ligjdhënës, egzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, direkte dhe demokratike;
- mbrojtja pronësore juridike;
- liritë e tregut dhe e afarizmit;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidare;
- vetëqeverisja lokale;

<sup>4</sup> Kundër Vendimit për shpalljen e referendumit votuan deputetët e partive politike shqiptare.

<sup>5</sup> Deputetët e partive politike shqiptare u përmbajtën në votim.

- rregullimi dhe humanizmi i hapësirës dhe mbrojtjes dhe përparimi i ambientit jetësor dhe natyror, dhe
- respektimi i normave të gjithëpranishme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozita e paragrafit të dytë të nenit 8 promovon hyrje dhe qëndrim liberal, duke proklamuar se "në Republikë e Maqedonisë, e lirë është gjithëçka që me Kushtetutë dhe ligj nuk është e ndaluar".

Një nga vlerat themelore të rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë është qeverisja e së drejtës (rule of law). Realizimi i saj është i mundur në kushte me të drejta dhe liri të garantuara dhe të mbrojtura juridikisht; supermatsioni i kushtetutës në rregullimin juridik, si edhe kontrolli kushtetues i ligjeve dhe kushtetutmëria dhe ligjëshmëria e dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme nga ana e Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë.

Parimi i sundimit të së drejtës çon nga pushteti i kufizuar, nga synimi demokratik, qytetarët t'u nënshtrohen jo njerëzve të tjerë por ligjeve (non sub homine sed sub lege), drejt politikës në kufijtë e së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, pluralizmin politik dhe zgjedhjet e lira, direkte dhe demokratike i numëron te vlerat themelore të rregullimit kushtetues. Në këtë mënyrë legjitimiteti i organeve më të larta të pushtetit lidhet me qytetarët të cilët në moshën 18 vjeçare përfitojnë të drejtën e votës së përgjithshme, direkte, të barabartë dhe të fshehtë.

Pluralizmi politik është pasojë natyrore e lirive politike të qytetarëve të garantuara me kushtetutë ku midis tjerash edhe liria e shoqërimit politik në parti politike dhe forma të tjera të organizimit politik, si element i pazavendësueshëm i jetës politike dhe instrument i përfaqësisë politike.

Partitë politike janë kusht pa të cilët s'ka demokraci parlamentare. Ato i artikulojnë dhe prezentojnë interesat dhe qëndrimet politike të qytetarëve me çka bëhen faktorë kryesor të kulturës politike, marrin pjesë në zgjedhjet me kandidatët e tyre, ndërmjetësojnë midis përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve - zgjedhësve e kontrollojnë pushtetin politik direkt ose nëpërmjet mendimeve politike.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë si vlerë themelore e përcakton edhe të shprehurin e lirë të përkatësisë nacionale, për shkak të theksimit të barabarshmërisë nacionale kundrejt rregullshmërisë nacionale.<sup>6</sup>

*Mbrojtja juridike e pronësisë*, si vlerë themelore, dmth garantim i këtij enti themelor ekonomik dhe juridik dhe trajtimi i formave të ndryshme të pronësisë së barabartë dhe të njëjlojshëm shumë të rëndësishëm për zhvillimin shoqëror në RM.

---

<sup>6</sup> Kjo vlerë themelore është e plotësuar me formulim " përfaqësimi kompetent dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë bashkësive në të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe institucioneve të tjera publike në të gjitha nivelet ( Amandamenti VI)

*E drejta e tregut dhe e afarizmit* është kategori e re në rregullimin kushtetues maqedon. Ajo do të thotë afirmimi kushtetues i tregtisë ekonomike dhe mbrojtja e tregut nëpërmjet kufizimit të intervenimit të shtetit në të.

*Humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti* si vlerë themelore janë bazë filozofiko- morale në shoqërinë e lirë, të hapur dhe demokratike të qytetarëve të barabartë, me integritet dhe dinjitet të garantuar.

Vetëqeverisja lokale është kundërpeshë e pushtetit qendror dhe institut më i afërt me qytetarët dhe për atë është edhe vlerë themelore e rregullimit kushtetues .

*Rregullimi dhe humanizmi i hapësirës dhe mbrojtjes dhe përparimi i ambientit jetësor dhe natyror* është përgjigje logjike kushtetuese e krizës bashkëkohore të ambientit jetësor që rrjedh nga moskontrollimi i industrisë, rritja ekonomike, bumi demokratik, pauperacioni, të cilët sollën deri në prishjen e baraspeshës në mes njeriut dhe natyrës dhe degradimit të hapësirës jetësore.

*Respektimi i normave dhe standardeve të miratuara të së drejtës ndërkombëtare* është parakusht për integrimin e Republikës së Maqedonisë në bashkësinë ndërkombëtare.

## 5. Ndryshimet e Kushtetutës së vitit 1991

Kushtetuta e vitit 1991 s'bënë dallim në mes pushtetit kushtetues dhe ligjor. Procesi për ndryshimin e saj është i njëjtë me procesin për sjelljen e kushtetutës së re.<sup>7</sup> Ndryshimi i kushtetutës rrjedh sipas procesit të vërtetuar në vetë Kushtetutën (nenet 129-131). Sipas nenit 129, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ndryshohet dhe plotësohet me amandamente kushtetuese. Procedura për ndryshimin e Kushtetutës shpalolet në këto faza : së pari, parashtrohet propozimi për hyrje në ndryshim , së dyti, sillet vendimi për hyrje në ndryshim , së treti, vërtetohet projekt - akti dhe parashtohet i njëjti në debatin publik, së katërti , sillet vendimi për ndryshimin e Kushtetutës dhe shpallet .

Propozim për hyrje në ndryshim të Kushtetutës mund të japë: Kryetari i RM, Qeveria e RM, së paku 30 deputetë ose 150 000 qytetarë. Vendim për hyrje në ndryshim të Kushtetutës sjell Kuvendi i RM me të dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve ( shumica kualitative). Projekti për ndryshimin e kushtetutës vërtetohet me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve ( shumicë absolute). Vendimi për ndryshimin e Kushtetutës sillet më dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve ( shumica kualitative). Pas miratimit të ndryshimit të Kushtetutës Kuvendi sjell Vendim për shpalljen e ndryshimeve kushtetuese. Ndryshimi i Kushtetutës hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes.

---

<sup>7</sup> Njëllor është edhe me Kushtetutën e Belgjikës të vitit 1831, Kushtetutën e Francës 1958, Kushtetutën e Kroacisë 1990

Kushtetuta e vitit 1991 disa herë është ndryshuar: në vitin 1992 me Amandamentin I dhe II, në vitin 1998 me Amandamentin III, në vitin 2001 me Amandamentin IV - XVIII dhe në vitin 2003 me Amandamentin XIX.

Amandamentet I dhe II deklarojnë se RM s'ka pretendim territorial në shtetet fqinje dhe se nuk do të ndërhyjë në të drejtat sovrane dhe punët e brendshme të shteteve të tjera...

Me Amandamentin III u zmadhua kohëzgjatja e paraburgimit deri në ngritjen e përgjegjësisë nga 90 deri në 180 ditë.

Me Amandamentet IV - XVIII u bënë ndryshime thelbësore në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, në bazë të Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Me këto Amandamente u vendos modeli i demokracisë konsensuale (konsociative) e shprehur me : përfaqësimin adekuat dhe të drejtë të qytetarëve të cilët u takojnë të gjithë bashkësive në organet e pushtetit shtetëror dhe instituteve të tjera publike në të gjitha nivelet; koncepti bashkësi; shumica speciale e nevojshme për sjelljen e ligjeve që përcaktojnë kulturën , përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentat personal dhe simbolet , si edhe Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji për organizimin territorial, Ligji për financimin lokal, Ligji për qytetin e Shkupit, Ligji për zgjedhjet lokale. Gjithashtu, me këto amandamente gjatë zgjedhjes së avokatit të popullit , tre anëtarëve të Gjyqit Kushtetues, tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor republikan është e nevojshme shumica e votave të deputetëve që u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, ndërsa gjatë emërimit të tre anëtarëve të Këshillit të sigurimit, Kryetari duhet të sigurojë që përbërja e Këshillit të paraqesë përbërjen e popullsisë në RM. Me Amandamentin XVII zgjerohen kompetencat kushtetuese të njësisë të vetëqeverisjeve lokale, ndërsa Amandamenti XVIII përshkruan shumicën e deputetëve të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në RM, përveç dy të tretave të votave të nevojshme me ndryshimet e dispozitave kushtetuese të cilat u përkasin të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive.

Në vitin 2003 me Amandamentin XIX u hap mundësia që me vendim të gjyqit të mund të, apstenohet nga fshehtësia e garantuar e formave të të shprehurit.

## **6. Struktura e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë**

Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë e përbëjnë preambula<sup>8</sup> dhe teksti normativ.

Preambula e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë e vitit 1991përmbante dy lloje dispozitash : ato të karakterit historiko-faktografik dhe ato të karakterit politoko-programor (qëllimet dhe vlerat e bashkësisë politike) - konstituimit të Republikës së Maqedonisë si shtet të pavarur dhe sovran, qytetar dhe demokratik; vendosja dhe ndërtimi i qeverisjes të së drejtës si sistem themelor i pushtetit, garantimi i të drejtave njerëzore, barazia nacionale dhe liritë qytetare,

---

<sup>8</sup> Në vokabularin politiko- juridik me preambulë (fjalë latine preambulum - parafjalë, hyrje,paralojë) nënkuptojmë pjesën e një akti juridik që i paraprin tekstit normativ nga i cili është dukshëm i ndarë dhe në të cilën janë të shprehura motivet dhe qëllimet e aktit. Stili i të shprehurit në preambulë është solemn, ndërsa ndonjëherë edhe patetik. Preambulat i ngjajnë manifestit politik, s'kanë nene dhe janë deklarative, d.m.th. s'kanë karakter normativ.

**sigurimi i paqës dhe i bashkëjetesës së popullit maqedon me popujtë e tjerë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë dhe sigurimi i drejtësisë sociale, mirëqenies ekonomike dhe përparimit të jetës personale dhe të jetë së përbashkët.**

**Me Amandamentin IV u bë ndryshimi i preambulës së Kushtetutë së Republikës së Maqedonisë të vitit 1991<sup>9</sup>. Preambula e re nomoteknike është e shprehur me një paragraf.**

**Në të theksohet se qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si edhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve vendosën t'a konstituojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur sovran.**

**Duke e marrë përgjegjësinë për të tashmen dhe për të ardhmen e Maqedonisë, themeluesit e Kushtetutës u japin falënderim gjeneratave paraprake për themelimin e Maqedonisë si shtet të pavarur dhe sovran, duke i theksuar ngjarjet më të rëndësishme historike, si Republikën e Krushevës, Vendimet e ASNOM-it dhe Referendumin e vitit 1991.**

**Themeluesit e Kushtetutës në Preambulë e shprehin edhe qëllimin e vendosjes dhe përforcimin e qeverisjes të së drejtës, të garantohen të drejtat njerëzore dhe liritë e qytetarëve, të sigurohet paqa dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët.**

**Preambula e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë është bazë dhe kornizë për interpretimin e tekstit normativ të Kushtetutës.**

**Teksti normativ i Kushtetutës ka nëntë pjesë dhe 134 nene : I. Dispozitat e përgjithshme (nenet 1-8); II. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit (nenet 9-60); III. Organizimi i pushtetit shtetëror ( nenet 61-107); IV. Gjyqji Kushtetues i Republikës së Maqedonisë (nenet 108-113); V.Vetëqeverisja lokale (nenet 114-117); VI.Marrëdhëniet ndërkombëtare (nenet 118-121); VII.Mbrojtja e Republikës, gjendje lufte dhe e jashtëzakonëshme (nenet 122-128); VIII. Ndryshimi i kushtetutës (nenet 129-131)dhe IX. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare (nenet 132-134).**

---

<sup>9</sup> Kjo është hera e parë të ndryshohet preambula pa sjelljen e kushtetutës së re në historinë e të drejtës kushtetuese komparative.